



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 5, Datë 17.01.2019

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO SETA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “HYDRO SETA” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 755 Prot., datë 26.11.2018, ka aplikuar për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 257, datë 17.12.2018, ka miratuar fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Pas kësaj vendimarrje, me shkresën nr. 55/71 Prot., datë 17.12.2018, u bë njoftimi në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 755/1 Prot., datë 20.12.2018, iu dërgua subjektit njoftim për vendimin përkatës.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k., për licensim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Proçedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikim, Transferim, Rinovim ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Seta” sh.p.k në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI